



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

V E N D I M

Nr. 19, datë 26.06.2025

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZONJËS ALMA FASKAJ (VOKOPOLA) NË
VENDIN VAKANT, PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR
NGA GJYKATA E LARTË MË DATË 11.12.2024**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryetar
Marjana Semini	Zëvendëskryetare
Ilir Toska	Anëtar
Alma Muça	Anëtare
Elvana Çiçolli	Anëtare zëvendësuese
Enkela Vlora	Anëtare relatore
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues
Etien Kapo	Anëtar
Nafije Hasko	Anëtare

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu, në prani të Avokates së Popullit, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e datës 26.06.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Alma Faskaj (Vokopola)

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 11.12.2024.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED-it, zonjës Enkela Vlora, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Informacion i përgjithshëm mbi kandidaturën dhe caktimin e relatorit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 11.12.2024, Gjykata e Lartë ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.

2. Në përfundim të afatit të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Gjykata e Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën përfshihej dhe kandidati Alma Faskaj (Vokopola), së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore, të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Në datë 15.01.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), realizoi procedurën e shortit për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja Enkela Vlora, ndërsa këshilltare ligjore Sonila Hoxha.

4. Në datë 17.01.2025, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t’u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Gjithashtu në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar; si dhe Vendimin nr.4, datë 11.3.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, kandidatin Alma Faskaj (Vokopola) i është njoftuar dhe emri i relatores dhe këshilltares së caktuar.

5. Në datën 17.01.2025, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) në rrugë elektronike, konfirmoi marrjen e njoftimit. Kandidati nuk ka bërë me dije shkaqe papajtueshmërie, konflikt interesi ose pengesa ligjore sipas nenit 222 dhe 223 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në lidhje me relatoren dhe këshilltaren.

6. Në datë 17.01.2025, kandidati Alma Faskaj (Vokopola), u paraqit pranë KED dhe tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimet e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi, midis të cilave edhe ato për deklarimin e pasurisë dhe interesave financiarë. Në datë 22.01.2025, kandidati është paraqitur pranë KED për dorëzimin e autorizimeve dhe deklarimeve përkatëse.

II. Verifikimi i kushteve dhe kritereve kushtetuese dhe ligjore të kandidimit

A. Procesi i deklarimit dhe kontrolli i pasurisë së kandidatit dhe familjarëve të tij sipas ligjit.

7. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, të nenit 7/a pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 8577/2000, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 64 prot, datë 29.01.2025, Këshilli i ka

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

dërguar, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procesit të kontrollit të pasurive, interesave financiarë dhe konfliktin e interesave, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367/2005).

8. Bashkëlidhur kësaj shkrese të drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është përcjellë dhe “Deklarata” e nënshkruar nga kandidati Alma Faskaj (Vokopola), në të cilën tregohet/konfirmohet se është pajisur me formularët përkatës të deklarimeve dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, dhe që mban datën 17.01.2025 të nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

9. Në zbatim të nenit të nenit 235 pika 2 të ligjit nr. 115/2016, të nenit 7/a pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 8577/2000, dhe pikës 61 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe përcaktimeve të neneve 3/1, 4 pika 2 e vijues të ligjit 9049/2003, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka plotësuar në mënyrë elektronike dhe ka dorëzuar të printuar e nënshkruar, brenda 15 ditëve, pranë ILDKPKI, Deklaratën e “pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, të konfirmuar nga kjo e fundit me shkresën nr. 766/1, datë 17.02.2025.

10. ILDKPKI, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, si dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe vendimit nr. 4 të datës 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pasi ka kryer, verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit, ka përcjell aktin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, Alma Faskaj (Vokopola) për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, me nr. 16/23 prot, datë 08.05.2025, ku është konkluduar se, për kandidatin Alma Faskaj (Vokopola):

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë,
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë,
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave

B. Procesi i deklarimi dhe kontrolli i integritetit të kandidatit.

11. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 66 prot., datë 31.01.2025 dhe shkresën nr. 74, datë 31.01.2025, Këshilli Emërimeve në Drejtësi ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Alma Faskaj (Vokopola) sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

12. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 206/04 prot., datë 12.02.2025, ka bërë me dije, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se: *"...nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik IMPRO.... i cili përmban të dhëna nga viti 2015 e në vazhdim për shtetasit e tjerë të cituar në shkresën tuaj, nuk rezulton asnjë praktikë e regjistruar në sistemin IMPRO"*.

13. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit të Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025, ka bërë me dije KED, si vijon: *"...Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimin e thelluar të të dhënave të vetëdeklaruar në formularin e plotësuar nga subjekt të këtij ligji, bazuar në kërkesën e bërë brenda 5 ditëve nga organi përgjegjës, për administrimin e formularit të vetëdeklarimit, vetëm për rastet kur ky i fundit, pas shqyrtimit dhe verifikimit paraprak të të dhënave, konstaton se:*

-subjekti/personi nuk ka deklaruar në formular asnjë fakt që ka të bëjë me të kaluarën e tyre penale, por ka indicie mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me....

-subjekti/personi ka deklaruar në formular të dhëna që kanë të bëjnë me rrethanat/faktet e sipërpërmendura dhe se prima facia të dhënat nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, por e kalon rastin për kontroll të thelluar, për të verifikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve, sipas ligjit;

-ka kërkesë të bërë pranë tij, si organ kompetent për verifikim të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Sipas kësaj dispozite, për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, të drejtën e nismës për të kërkuar verifikimin e të dhënave, pranë organit kompetent për verifikim, sipas këtij ligji, e ka 1/10 e deputetëve, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Në këtë rast, organi përgjegjës dhe kompetent, për administrimin e formularit dhe verifikimin paraprak të të dhënave, në kërkesën për verifikim të thelluar specifikon subjektin e nenit 7 të ligjit nr. 138/2015 që ka kërkuar verifikimin dhe të dhënat, faktet apo rrethanat që përmban kërkesa e tij e që përbëjnë shkak për zbatimin e këtij ligji.....Për sa më sipër, mbështetur në nenet 44, 62 e 64 të Kodit të Procedurave Administrative, ju kërkohet plotësimi i pasaktësive/ të metave brenda njëzetë ditëve. Mosplotësimi i tyre brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës". Në vijim të shkresës nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025 të Prokurorisë së Përgjithshme, është përcjell nga ky institucion me shkresën nr. 206/19 prot., datë 07.03.2025, vendimi i datës 07.03.2025 "Për mospranimin e kërkesës për verifikim", të të dhënave të plotësuar në zbatim të ligjit nr. 138/2015, në formularin e vetëdeklarimit datë 22.01.2025 për kandidatin Alma Faskaj (Vokopola).

14. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", si edhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si organi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

kompetent i administrimit të vetëdeklarimeve dhe zbatimin e ndalimeve për kandidatin, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion:

- me shkresën nr. 70 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën nr. 1616/1 prot., datë 07.02.2025, ka kthyer përgjigje se: “...rezultojnë pa shënime në sistem...”;
- me shkresën nr. 73 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile e cila me shkresën nr. 1166/1 prot., datë 12.02.2025, ka kthyer përgjigje se: “ka ndryshuar mbiemrin nga Vokopola në Faskaj me martesë”.
- me shkresën nr. 68 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, e cila me shkresën nr. 543/4 prot., datë 10.02.2025, ka kthyer përgjigje se: “Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasit.... nuk janë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga strukturat e Policisë së Shtetit për kryerjen e ndonjë veprë penale; nuk figurojnë të regjistruar me identitet tjetër; nuk rezultojnë të kthyer deportiv apo të dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër; nuk rezulton të kenë urdhër kërkimi ndërkombëtar nga ndonjë autoritet gjyqësor i huaj”.

15. Gjatë procesit të verifikimit të kryer në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 e nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016, të pikave 79-87 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për këtë kandidat:

- nuk ka konstatuar asnjë të dhënë apo fakt, indicie mbi bazën e një kërkese, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me:
 - dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë, apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit.
- nuk ka konstatuar të deklaruara në formular të dhëna që kanë të bëjnë me faktet e sipërpërmendura apo të dhëna që *prima facia* të përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015;
- nuk ka konstatuar që të jetë kërkuar, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës, për verifikimin e të dhënave në Formularin e Vetëdeklarimit, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

C. Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

16. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Alma Faskaj (Vokopola) në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si dhe nga informacionet e siguruar nga KED, zyrtarisht në kuadër të këtij procesi.

i. Kontrolli mbi gjendjen gjyqësore dhe proceset penale të regjistruar ndaj kandidatit (neni 7/a, pika 1 germa “ç” i ligjit nr. 8577/2000)

17. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola) sikurse është cituar dhe më sipër në pikën 14 të këtij vendimi, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion, me shkresën nr. 70 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën nr. 1616/1 prot., datë 07.02.2025, ka kthyer përgjigje se: *“...rezultojnë pa shënime në sistem...”*.

18. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, me shkresën nr.206/4 prot., datë 12.02.2025, ka bërë me dije, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se: *“...nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik IMPRO.... i cili përmban të dhëna nga viti 2015 e në vazhdim për shtetasit e tjerë të cituar në shkresën tuaj, nuk rezulton asnjë praktikë e regjistruar në sistemin IMPRO”*.

19. Në vijim të shkresës nr. 66 prot., datë 31.01.2025 të KED, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. 206/44 prot., datë 29.04.2025 është përcjell verifikimi i kryer nga prokuroritë e rretheve, ku evidentohet si vijon:

- Me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, lidhur me kandidatin referon: *“Nuk rezulton të jetë regjistruar kallzime/referime/procedime penale; Nuk rezulton i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprës penale si person i dyshuar; Nuk është ndaluar apo arrestuar në flagrance; Nuk i është caktuar ndonjë masë sigurimi personal”*
- Me shkresën nr. 1068/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, lidhur me kandidatin referon: *“... nuk është në hetim, apo i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale në Prokurorinë Dibër”*.
- Me shkresën nr. 1383 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, lidhur me kandidatin referon: *“.. nuk rezulton në hetim apo i dënuar me vendim të formës së prerë”*.
- Me shkresën nr. 4377/1 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, lidhur me kandidatin referon: *“nga*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

verifikimet i kryer nga zyra e regjistrat dhe zyra e arkivës nuk rezultojn të jetë regjistruar material kallëzues apo procedim penal..”.

- Me shkresën nr. 1297 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, lidhur me kandidatin referon: *“Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi; Nuk është kërkuar masë sigurimi personal; Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim; Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale; Nuk ka pasur rast të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit”.*
- Me shkresën nr. 4233 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, lidhur me kandidatin referon: *“Nuk ka filluar ndjekje penale dhe nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë me kërkesën e kësaj Prokurorie”.*
- Me email të datës 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka referuar se pas verifikimeve të bëra në regjistrat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nuk rezultojn të jenë në hetim, apo jetë dhënë vendim gjykatë jo përfundimtar apo i formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale brenda territorit Republikës së Shqipërisë apo jashtë shtetit, në ngarkim të shtetasve sipas listës emërore, cituar në kërkesën.
- Me shkresën nr. 7343 prot., datë 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, lidhur me kandidatin referon: *“Nuk ka filluar ndjekje penale dhe nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë..”*
- Me shkresën nr. 2513 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, lidhur me kandidatin referon: *“nuk rezultojn të jenë në hetim dhe nuk rezultojn të jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale..”.*
- Me shkresën nr. 1862/1 prot., datë 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, lidhur me kandidatin referon: *“nuk është regjistruar asnjë procedim penal”.*
- Me shkresën nr. 5380/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, lidhur me kandidatin referon: *“Prokuroria nuk ka në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë..”.*
- Me shkresën nr. 3528 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, lidhur me kandidatin referon: *“nuk rezultojn të jenë në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale..”.*
- Me shkresën nr. 11061/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me kandidatin referon: *“Nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore vitet 2022-2025, nuk rezultoi të ketë procedim penal të regjistruar në ngarkim të shtetasve të lartëpërmendur”.*

20. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me shkresat nr. 75 prot., - nr. 91 prot., datë 31.01.2025, ka kërkuar informacion pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Lartë. Në lidhje me kandidatin Alma Faskaj (Vokopola), e cila renditet e dyta në listën e kandidatëve të përcjell për verifikim, gjykatat kanë përcjell informacionin vijues:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : ***GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : ***info@ked.gov.al*** Numra telefonikë : ***+355 4 2257302***

- Me shkresën nr. 611/1 prot., datë 10.02.2025, Gjykata e Lartë ka referuar: “.. nuk rezulton që pranë kësaj gjykate të ketë të regjistruar çështje penale në emër të shtetasve ... Alma Faskaj..”.
- Me shkresën nr. 183/1 prot., datë ska, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përcillet informacioni se për kandidatin Alma Faskaj (Vokopola) rezulton se: “..a. Nuk rezulton të jetë regjistruar për shqyrtim asnjë çështje penale në ngarkim të tyre; b. Nuk janë dhënë vendime penale qoftë të formës së prerë, apo jo, në ngarkim të tyre”.
- Me shkresën nr. 396/1 prot., datë 10.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcillet informacioni se për kandidatin Alma Faskaj (Vokopola) rezulton se: “Pas verifikimeve të kryera në sekretarinë e gjykatës, rezulton se në lidhje me shtetasit e sipërcituar nuk janë dhënë vendime penale si dhe aktualisht nuk kanë çështje penale në gjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.
- Me shkresën nr. 2283/1 prot., datë 04.02.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është evidentuar se: “....për periudhën 2007-02.02.2025, nuk rezultojnë të regjistruara për shqyrtim/gjykuara çështje penale në ngarkim të shtetasve të mëposhtëm:..”
- Me shkresën nr. 114/1 prot., datë 04.02.2025 të Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është evidentuar se: “...rezulton se kandidatët e sipër cituar, nuk kanë pasur çështje penale si dhe nuk kanë vendim penal të formës prerë ose jo ndaj tyre”.
- Me shkresën nr. 212/1 prot., datë 04.02.2025 të Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Berat është evidentuar se: “Sipas verifikimit në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk rezulton çështje penale e regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në ngarkim të tetë shtetasve të listuar në listën bashkëlidhur të dërguar nga ana juaj”.
- Me shkresën nr. 547/1 prot., datë 07.02.2025 e Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është evidentuar se: “...nuk rezultojnë të kenë qenë apo të jenë aktualisht si palë ndërgjyqëse në vendime apo procese gjyqësore në shqyrtim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.
- Me shkresën nr. 225/1 prot., datë 04.02.2025 e Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është evidentuar se: “..nuk rezulton që keta shtetas të kenë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedimin penal, apo të jetë marrë vendim për të zbatuar/revokuar /shuarje mase sigurimi me karakter personal ose pasuror,apo të kenë procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara vendime dënimi apo pafajësie.
- Me shkresën nr. 1070/1 prot., datë 05.02.2025 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është evidentuar se: “..Nuk rezulton që për kandidatët...., të jenë regjistruar çështje penale apo të jenë dhënë vendime penale pranë kësaj gjykate në ngarkim të tyre apo të kenë çështje për shqyrtim”.
- Me shkresën nr. 27 prot., datë 27.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë është evidentuar se: “..nuk është proceduar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
- Me shkresën nr. 464/1 prot., datë 10.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është evidentuar se: “..nga verifikimi i sistemit ICMIS nuk rezulton asnjë çështje gjyqësore...”.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

- Me shkresën nr. 162/1 prot., datë 10.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është evidentuar se: *“... nuk rezulton të ketë proces penal, të jetë duke u verifikuar, marr vendim zbatuar/revokuar/shuar masë sigurimi me karakter personal ose pasuror, apo të kenë vendime dënimi apo pafajësie, në ngarkim të tyre”*.
- Me shkresën nr. 109/1 prot., datë 06.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është evidentuar se: *“..nuk rezulton të ketë të dhëna për procedime penale të filluara apo vendime penale të formës së prerë ose jo në të cilat përmendet emri ...”*.
- Me shkresën nr. 89/1 prot., datë 07.02.2025 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është evidentuar se: *“..nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë në ngarkim...”*.
- Me shkresën nr. 211/1 prot., datë 10.02.2025 e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është evidentuar se: *“...Nga kërkimi i indekseve dhe sistemeve, për llogari të shtetasve ...Alma Hakik Faskaj..., nuk rezulton të kenë patur të regjistruar çështje penale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Po ashtu Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk rezulton të ketë dhënë vendime penale për shtetasit (me datëlindjet përkatëse) e mësipër listuar. Vendosim në vëmendjen tuaj se ky informacion nuk përmban të dhëna mbi çështje që përbëjnë sekretet hetimor (përgjime apo gjykime të kësaj kategorie) si dhe vendime penale të gjykatës me objekt "Pushimin e çështjes penale", kur subjektit nuk i është regjistruar emri në regjistrin e procedimeve (gjykime paraprake me objekt "Pushimin e procedimit penal nr.../ viti"), pasi nuk regjistrohet emri as në sistemet e gjykatës apo regjistrat e saj”*.
- Me shkresën nr. 467/3 prot., datë 19.02.2025 e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është evidentuar se: *“Nga verifikimi realizuar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Penale për periudhën viti 2002 (vit kur fillon Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Penal) deri në datën e kësaj shkrese, lidhur me shtetasit e sipërcituar nuk rezulton të jetë regjistruar ose dhënë ndonjë vendim themeli penale /masa sigurimi në ngarkim të tyre...”*.
- Me shkresën nr. 599/1, datë 11.02.2025 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka evidentuar: *“Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), dhe verifikimi i kryer në indekset penale të administruara pranë Zyrës së Arkivës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nuk rezulton që pranë kësaj gjykate të jetë dhënë vendim penal i formës së prerë apo të jetë regjistruar për shqyrtim çështje penale...”*.

21. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. 71 prot., datë 31.01.2025, i ka kërkuar informacion dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim SPAK), e cila, me shkresën nr. 7717 prot., datë 28.02.2025, ka kthyer përgjigje se:

“... ju konfirmojmë se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e procedimeve penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të kandidatëve të mëposhtëm, të cilët do të përfshihen në shortin për zgjedhjen si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese: ... Alma Hakik Faskaj, datëlindja 21.08.1973, nr. personal H35821075Q. ...

Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e kallëzimeve të veprave penale të të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ju informojmë se ...

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Në lidhje me shtetasen Alma Faskaj, rezultojnë këto të dhëna:

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallzimi Nr. 107, i vitit 2020, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr. 160, viti 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 186, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar. Pas përfundimit të hetimeve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin Nr.28, datë 11.02.2021, ka vendosur pushimin e procedimit Nr. 160, viti 2020.

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallzimi Nr.72, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.03.2021.

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallzimi Nr.272, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 14.09.2021. ...”

22. Gjithashtu, bashkëlidhur kësaj shkrese, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka përcjellë pranë KED, ndër të tjera, aktet si vijon:

- Vendim “Për pushimin e çështjes” nr. 28, datë 11.02.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin është vendosur pushimi i procedimit/çështjes penale nr. 160, të vitit 2020, regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, në bazë të nenit 328/1/a të Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim ka shënimin që kundër tij është bërë ankim nga shtetasja Hajrie Muçmata dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 115, datë 06.05.2021;
- Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” datë 29.03.2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për kallëzimin penal nr. 72/2021, pasi fakti nuk përbën vepër penale;
- Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” datë 14.09.2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për kallëzimin penal nr. 272, datë 08.09.2021.

23. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në vijim të informacionit shtesë të kërkuar nga KED (lidhur me faktin nëse është ushtruar ankim ndaj vendimeve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për mosfillimin e procedimit penal datë 29.03.2021 (për kallëzimin nr. 72/2021) dhe datë 14.09.2021 (për kallëzimin nr. 272/2021), me shkresën nr. 13137 prot., datë 16.04.2025, ka bërë me dije KED se:

“Në lidhje me shtetasen Alma Faskaj, rezultojnë këto të dhëna:

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallëzimi Nr.107, i vitit 2020, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr. 160, viti 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 186, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar. Pas përfundimit të hetimeve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin Nr.28, datë 11.02.2021, ka vendosur pushimin e procedimit Nr. 160, viti 2020.

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallëzimi Nr.72, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.03.2021. Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses. Me vendimin Nr.123 datë 03.06.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit të kallëzueses. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e cila me vendimin Nr.177, datë

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

21.07.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr.123 datë 03.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallëzimi Nr.272, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 14.09.2021.

Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Me vendimin Nr.352 datë 25.10.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur me vendimin Nr.disponimi 267, datë 22.12.2021. Nga ana e kërkuarit është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin Nr.00-2022-482, datë 12.04.2022, ka vendosur prishjen e vendimit Nr.267, datë 22.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur miratimin e vendimit Nr.352, datë 25.10.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”

24. Gjithashtu, bashkëlidhur kësaj shkrese, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka përcjellë pranë KED, ndër të tjera, aktet si vijon:

- Vendim nr. 123, datë 03.06.2021 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin është rrëzuar ankimi i ankueses R.Gj., ndaj vendimit të datës 29.03.2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. 72/2021. Vendim nr. 177, datë 21.07.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me të cilin është miratuar vendimi nr. 123, datë 03.06.2021 i GJKKO.
- Vendim nr. 352, datë 25.10.2021 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin është rrëzuar ankimi i ankuesit A.B., ndaj vendimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. 272/2021.
- Vendim nr. 267, datë 22.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me të cilin është ndryshuar vendimi nr. 352, datë 25.10.2021 i GJKKO dhe shfuqizimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 272/2021.
- Vendim nr. 482, datë 12.04.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur prishja e vendimit nr. 267, datë 22.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimi për rigjykim, me tjetër trup gjykues.
- Vendim nr. 111, datë 28.06.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me të cilin është miratuar vendimi nr. 352, datë 25.10.2021 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin është rrëzuar ankimi i ankuesit A.B., ndaj vendimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. 272/2021.

25. Në vijim të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi iu ka kërkuar informacion, me shkresën nr. 67 prot., datë 31.01.2025 Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 72 prot., datë 31.01.2025, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (ish Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave) pranë Ministrisë së Brendshme.

26. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 1345 prot., datë 12.03.2025 ka evidentuar se: *“Në përfundim të procedurave të verifikimit, autoritetet verifikuese na informojnë se nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e znj. Alma Hakik Faskaj, në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme. Për kandidaten e lartpërmendur, janë aplikuar standardet e parashikuara në nenin 38 "Standardet e kontrollit të figurës, të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

27. Ndërsa, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. 658/1 prot., datë 11.02.2025 ka evidentuar se: *“Nuk ka të dhëna për kontakte apo lidhje të tyre me persona të papërshtatshëm apo të përfshirë në krimin e organizuar”.*

28. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 69 prot., datë 31.01.2025, Këshilli i ka dërguar, formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Alma Faskaj (Vokopola), për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.*

29. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, pas kontrollit të ushtruar, me shkresën nr. 222/3 prot., datë 14.02.2025, ka përcjellë, në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 71, datë 13.02.2025, me të cilën është konkluduar se: *“.... Për znj. Alma Faskaj (Vokopola), nga verifikimet e kryera deri tani, bazuar në përcaktimet e nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar rezulton se: 1. Nuk kanë qenë persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; 2. Nuk kanë qenë bashkëpunëtor anëtar ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit. 3. Nuk figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, deri në 2 korrik 1991, sipas përcaktimeve të Nenit 29, pika 2 Ligjit Nr.45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar. ...”*

ii. Kontrolli mbi shtetësinë dhe zotësinë për të vepruar.

30. Neni 7/a pika 1 shkronja “a” e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar. Kandidati Alma Faskaj (Vokopola), me atësi Hakik, amësi Vita, lindur më datë 21.08.1973, në Lushnjë dhe banuese në Tiranë, me nr. personal H35821075Q, sipas certifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, rezulton me shtetësi shqiptare. Përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që kandidatin t’i jetë hequr apo t’i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

iii. Kontrolli mbi arsimin e kandidatit

31. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë mbaruar

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Alma Faskaj (Vokopola), ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë, në periudhën 1991-1995, duke u diplomuar “Jurist” në datë 11.07.1995. Në zbatim të neneve 75 dhe 124 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

32. Në aktet e administruara në dosjen e kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), ka rezultuar i provuar fakti se, kandidati ka kryer studime pasuniversitare në programin “Master në Shkencat Juridike në të Drejtë Publike” pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Publike, në periudhën 2002-2006 dhe në datën 08.07.2011 ka mbrojtur mikrotezën me temë “Procedimi administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, kandidati ka kryer studime doktore pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe ka fituar gradën shkencore “Doktor” në të drejtën publike (disertacion me temë “Procedimi administrativ në Republikën e Shqipërisë”), me nr. 828 diplome, datë 09.06.2014.

iv. Kontrolli për ushtrim funksione politike/pozicione drejtuese në parti politike

33. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 2, datë 23.02.2022, ka miratuar ndryshimet në vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, duke bërë pjesë të tij “Formularin e vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”, i cili u botua në fletoren zyrtare nr. 33, datë 01.03.2022. Këto ndryshime u kushtëzuan nga fakti se në praktikën e KED në vitet të mëparshme, partitë politike, nuk dërgonin informacionin e nevojshëm, duke ndikuar dhe vështirësuar marrjen e informacionit lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin e kandidatëve në ndonjë pozicion drejtues në parti politike. Në zbatim të këtij detyrimi kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit datë 22.01.2025, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike. Gjithashtu rezulton se gjatë periudhës së verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë ndryshe, apo ndonjë informacion nga persona të tretë lidhur me këtë fakt.

33.1 Po ashtu, sillet në vëmendje se lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *“të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 të fundit nga data e kandidimit”*, nuk rezulton që kandidati të ketë ushtruar funksione politike në administratën publike.

v. Kontrolli mbi përvojën profesionale të kandidatit në punë.

34. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

nivelit të lartë në administratën publike. Nga librezja e punës së kandidatit rezulton e dokumentuar përvoja e punës si vijon:

1. Nga data 30.08.1995 deri në datë 23.08.1996 – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë – periudha e punësimit 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 24 (njëzet e katër) ditë.
2. Nga data 09.12.1996 deri në datë 31.07.1998 – Juriste pranë Këshillit të Rrethit Lushnjë – periudha e punësimit 1 (një) vit, 7 (shtatë) muaj, 22 (njëzet e dy) ditë.¹
3. Nga data 01.08.1998 deri në datë 15.08.2000 – Asistent pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës – periudha e punësimit 2 (dy) vjet e 14 (katërmëdhjetë) ditë.
4. Nga data 16.08.2000 deri në datë 01.05.2001 – Ndhmës Komisioner pranë Avokatit të Popullit – periudha e punësimit 8 (tetë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.
5. Nga data 01.05.2001 deri në datë 05.12.2011 – Këshilltar pranë Avokatit të Popullit – periudha e punësimit 10 (dhjetë) vjet, 7 (shtatë) muaj e 4 (katër) ditë.
6. Nga data 05.12.2011 deri në datë 01.04.2014 – Ndhmës Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme – periudha e punësimit 2 (dy) vjet, 3 (tre) muaj e 27 (njëzet e shtatë) ditë.
7. Nga data 01.04.2014 deri në s’ka datë largimi² – Këshilltar në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit (Kuvendi) – periudha e punësimit 3 (tre) vjet, 2 (muaj) e 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë³.
8. Nga data 17.06.2017 deri në datë 31.12.2024 – Komisioner pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – periudha e punësimit 7 (shtatë) vjet, 6 (gjashtë) muaj e 14 (katërmëdhjetë) ditë.

35. Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka deklaruar se, ka përmbushur edhe veprimtaritë profesionale të mëposhtme:

1. 2010 - Maj 2017 - Lektore në trajnimin fillestar dhe vazhdues, Shkolla e Magjistraturës.
2. Gusht 2004- Maj 2017 - Pedagoge e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë Jo Publik "Luarasi", "Justizia", "Justiniani".

36. Në lidhje me verifikimin e kriterit të vjetërsisë, masave disiplinore dhe performancës në detyrë, në përputhje me kërkesat e nenit 7/a, pika 2 e Ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" KED ka çmuar të nevojshme të verifikoj për aq sa rezulton e mundur të gjitha marrëdhëniet e punës, rrjedhimisht i është drejtuar institucioneve pranë të cilave rezulton se kandidati ka ushtruar marrëdhëniet e punësimit sipas pasqyrimit në librezën e punës dhe jetëshkrim. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave "b", "c" dhe "d" të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 - 93 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, pavarësisht të dhënave të pasqyruara nga librezja

¹¹ Vetë kandidatja në jetëshkrim ka përmendur si periudhë pune Shtator 1996 – Gusht 1998 pozicionin "Nënkryetare" e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Lushnjë, por ky pozicion dhe kjo periudhë nuk konfirmohet e plotë me dokumentacion ligjor. Sipas librezës së punës rezulton e shënuar periudha 9.12.1996-31.07.1998, si Juriste në Këshillin e Rrethit Lushnjë.

² Sipas vërtetimit të lëshuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë rezulton datë largimi data 19.06.2017, ndërsa në libezë pune nuk është shënuar data e largimit nga ky pozicion.

³ Sqarim: Duke qenë se në librezë punë nuk është shënuar data e largimit nga detyra "Këshilltar në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit (Kuvendi)", për llogaritjen e kohëzgjatjes së qëndrimit në këtë funksion është llogaritur si datë përfundimi i marrëdhënies së punës data 17.06.2017, datë në të cilën ka filluar ushtrimin e detyrës së Anëtarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas përmbajtjes së librezës së punës.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

e punës, jetëshkrimi apo edhe dokumentacionit shkresor të paraqitur nga kandidati, Këshilli për shkak të kryerjes së një hetimi të thelluar në drejtim të këtij kriteri, ka kryer një korrespondencë shkresore më të gjithë institucionet ku kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka ushtruar veprimtari profesionale, duke kërkuar informacion për këto çështje: (i) marrjen e konfirmimit të periudhës kohore që ka ushtruar veprimtari profesionale pranë tyre; (ii) kërkimin e akteve të emërimit dhe të largimit nga detyra; (iii) konfirmimin dhe marrjen e të dhënave në lidhje me performancën në punë (masa disiplinore apo shkakun e largimit nga detyra); (iv) përshkrimin e detyrave funksionale dhe veprimtarinë ligjore që ka mbuluar në kryerjen e këtyre detyrave.

37. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si gjyqtare, Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. 1102/1 prot., datë 28.02.2025 ka bërë me dije KED se, *“Znj. Alma Faskaj (Vokopola) me vendim nr. 6, datë 30.08.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Lushnjë. Me vendim nr. 8, datë 23.08.1996 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkohet nga detyra për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë, referuar të dhënave të Regjistrat Themeltar të Ministrisë së Drejtësisë (kopje e njëzuar e të cilit ndodhet edhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor).”*

38. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si gjyqtare, Ministria e Drejtësisë me shkresën 1159/1 prot., datë 17.03.2025, ka bërë me dije KED se, *“...Znj. Alma Faskaj (Vokopola), ka punuar në periudhën dhe pozicionin, sa më poshtë: Nga data 30.08.1995-23.08.1996, Gjyqtare në Lushnje, shkarkohet nga detyra.”*

39. Në datë 12.03.2025, nëpërmjet komunikimit elektronik kandidati Alma Faskaj (Vokopola) është njoftuar lidhur me informacionin e përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. 1102/1 prot., datë 28.02.2025, si dhe i është bërë e ditur e drejta e paraqitjes së qëndrimit të tij ose/dhe dokumentacioni, brenda një afati pesë ditor. Kandidati Alma Faskaj (Vokopola) nëpërmjet shërbimit postar (datë dorëzimi në postë 17.03.2025), ka paraqitur në datë 19.03.2025 parashtrime me shkrim (3 fletë) dhe dokumentacion shoqërues, duke parashtruar në thelb se, pavarësisht nga fakti se Gjykata Kushtetuese nuk është shprehur në dispozitiv për shfuqizimin e aktit (vendimit), ky mund të jetë një omëtim, pasi në arsyetimin e vendimit kjo gjykatë shprehet për shfuqizimin e vendimit. Sipas kandidatit në logjikën juridike, nëse në dispozitiv Gjykata detyron organin për ta rishqyrtuar padyshim e ka shfuqizuar këtë vendim *de jure*. Gjithashtu, kandidati parashtron se, Gjykata Kushtetuese, duke qenë se po investohej disa herë nga subjekte të ndryshëm për të njëjtin vendim, të cilin e kishte shfuqizuar për shkelje të rënda procedurale, çmoi përgjigjen në rrugë administrative dhe jo me një vendim. Sipas kandidatit është plotësisht e qartë që vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është një vendim i nxjerrë në shkelje të procedurës, pa marrë në konsideratë anën materiale të vendimmarrjes së tij për secilin prej subjekteve që ju është drejtuar. Për këtë arsye ky vendim ka fuqi dhe për të gjithë subjektet që janë shkakuar më atë vendim.

40. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Këshillit të Rrethit Lushnjë, si Jurist, Agjencia e Trajtimit të Pronave me shkresën nr. 2618/1 prot., datë 12.05.2025, ka bërë me dije KED se, *“ATP është e organizuar dhe funksionon në bazë dhe zbatim të ligjit Nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i ndryshuar. Referuar suajës me anë të së cilës kërkoni informacion për periudhën e punësimit të Znj. Alma Hakik Faskaj pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë Këshillit të Rrethit Lushnjë, ju informojmë se nga verifikimet e kryera, në arkivën e ATP-së (ish-AKKP) dhe në Sektorin e Burimeve Njerëzore nuk disponohet dokumentacion për Znj. Alma Hakik Faskaj. ATP disponon dokumentacion për punonjësit e (ish-AKKP-së) ATP-së nga viti 2004 e në vijim.”*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

41. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, me shkresën nr. 185/1 prot., datë 21.02.2025, ka bërë me dije KED se,

“2. Alma Hakik Faskaj (Vokopola). Vijueshmëria e marrëdhënies së punës: Kandidatja ka qenë pedagoge efektive në Departamentin e së Drejtës Publike, pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në periudhën 01.08.1998-18.08.2000. Ndërprerja e marrëdhënieve të saj të punës është bërë me kërkesë të saj.

Kandidatja ka qenë asistent-pedagoge efektive. Detyra funksionale: Ajo ka qenë asistent-pedagoge efektive pranë Fakultetit të Drejtësisë.

Ajo gjithashtu ka qenë pedagoge me kohë të pjesshme, në cilësinë e asistent-pedagoges, në Departamentin e së Drejtës Publike, pranë Fakultetit të Drejtësisë në vitin akademik 2002-2003 në zhvillimin e seminareve të lëndës "E Drejtë Administrative", në vitin akademik 2003-2004, në vitin akademik 2004-2005 në zhvillimin e seminareve të lëndës "E Drejtë Administrative", në semestrin e dytë të vitit akademik 2009-2010 në zhvillimin e leksioneve të lëndës "E Drejtë Administrative" dhe në semestrin e dytë të vitit akademik 2016-2017 në zhvillimin e seminareve të lëndës "E Drejtë Administrative".

Vlerësime performance: Në dosjen e personelit të larguar, që disponohet pranë Degës së Burimeve Njerëzore, nuk ka vlerësime të performancës në detyrë.

Masat disiplinore: Në dosjen e personelit të larguar, që disponohet pranë Degës së Burimeve Njerëzore, nuk ka informacion për masat disiplinore.”

42. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Avokatit të Popullit, si Ndhimëskomisioner dhe Këshilltar, Avokati i Popullit me shkresën nr. 142/1 prot., datë 28.02.2025, ka bërë me dije KED se,

“... Znj. Alma Faskaj ka filluar marrëdhënien e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit më datë 16.08.2000 në rolin e Ndhimëskomisionerit në Seksionin e Përgjithshëm. Akte të cilat provojnë fillimin e marrëdhënies së punës për Znj. Faskaj janë Urdhëri i Brendshëm i Departamentit të Personelit dhe Financës me Nr. 21 Prot. datë 16.08.2000 i cili e shpall fituese në pozicionin e sipërpërmendur, si edhe kontrata e punës me afat 1-vjecar e lidhur nga Znj. Faskaj me institucionin e Avokatit të Popullit në po të njëjtën datë.

Urdhëri i brendshëm me Nr. 220 Prot. datë 19.04.2001, pasqyron lëvizjen nga pozicioni i Ndhimeskomisionerit në atë të Këshilltares së Avokatit të Popullit, pozicion në të cilin ka filluar punë në datë 01.05.2001 dhe e ka mbajtur deri në momentin që ka bërë kërkesë për dorëheqje në datë 02.12.2011 për shkak të emërimit në pozicionin e Ndhimese Ligjore pranë, Prokurorisë së Përgjithshme.

Për sa i përket detyrës funksionale dhe natyrës së punës në pozicionin e Ndhimes Komisionerit, subjekti i vlerësimit është marrë kryesisht me ankesat për fushat administrative, gjyqësore, strehimit dhe pronësisë, duke realizuar ndjekjen e rasteve dhe përgatitjen e rekomandimeve.

Po ashtu në pozicionin e Këshilltares së Avokatit të Popullit, në sajë të trajtimit të ankesave dhe raportit përfundimtar që i paraqet Avokatit të Popullit, ka bashkëpunuar me Komisioneret në procesin e shqyrtimit të çështjeve sipas udhëzimeve të dhëna nga titullari i Institucionit. Për më tepër detyrat që ka kryer në këtë pozicion ishin të jepte mendime për projektligje apo drafte aktesh nënligjore që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut si edhe të marrë pjesë dhe të përfaqësojë me autorizim të Avokatit të Popullit Institucionin në grupet e punës për përgatitjen e raporteve kombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut.

Referuar dy pikave të fundit të shkresës për kërkimin e informacionit, po bashkangjisim aktet përkatëse të emërimit dhe vlerësimet e punës për punonjësen.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Gjithashtu ju bëjmë me dije se gjatë periudhës se cilës ka ushtruar detyrat në Institucionin e Avokatit të Popullit, nuk ka patur masa disiplinore të marra ndaj Znj. Alma Faskaj.”. Konstatohet se bashkë me informacionin e mësipërm, Avokati i Popullit ka përcjellë pranë KED, aktet si vijon:

- Urdhër i Brendshëm i Avokatit të Popullit nr. 211 prot., datë 16.08.2000, sipas të cilit Alma Vokopola, fitues në konkursin e punësimit, emërohet në detyrën e Ndhmëskomisionerit, me pagë mujore 45.980 lekë, pranë Seksionit të Përgjithshëm, dhe se kontrata e punës do të lidhet me afat 1 vjeçar duke filluar nga data 16.08.2000;
- Urdhër i Brendshëm i Avokatit të Popullit nr. 220 prot., datë 19.04.2001, sipas të cilit Alma Faskaj me detyrën e Ndhmëskomisionerit kalon në detyrën e Këshilltares së Avokatit të Popullit, me pagë mujore 56.870 lekë dhe se marrëdhëniet financiare në këtë detyrë fillojnë në datë 1.5.2001;
- Urdhër i Brendshëm i Avokatit të Popullit nr. 391 prot., datë 10.08.2001, sipas të cilit mbështetur në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, neni 14, shkronja “a”, Alma Faskaj, me detyrën e Ndhmëskomisionerit në Seksionin e Përgjithshëm, mbasi kalon periudhën 1 vjeçare të provës nga data 16.08.2000-16.08.2001, merr konfirmimin si nëpunës civil.
- Vlerësim pune për vitet 2008 dhe 2009.

43. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Prokurorisë së Përgjithshme si ndihmës ligjor, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional me shkresën nr. 274/3 prot., datë 03.03.2025, ka bërë me dije KED se,

“3. Alma Hakik Faskaj është emëruar në detyrë e ndihmëses ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme me Urdhrin nr. 211 datë 02.12.2011 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe e ka ushtruar këtë detyrë deri më datë 01.04.2014 ku pas kërkesës së saj për dorëheqje është bërë largimi nga detyra me Urdhrin nr. 71, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në këtë periudhë znj. Faskaj ka ushtruar detyrën pranë Drejtorisë Gjyqësore dhe detyrat e saj funksionale konsistojnë; - Në studimin e ankimeve, dosjeve penale, administrimin e materialeve pranë Gjykatës Lartë ose Gjykatës Kushtetuese dhe përgatitjen e relacionit për prokurorin, ku evidentoheshin problemet ligjore të nevojshme për t'u zgjidhur, duke bërë dhe sugjerimet përkatëse për çështjet objekt gjykimi. - përgatitja e informacionit së bashku me aktet e administruara nga gjykata, prokurorit të shortuar për përfaqësimin e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese. -ka ndjekur në dinamikë praktikën gjyqësore penale të vendimeve njësuere, unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në fushën penale, vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përgatit përmbledhje informative për prokurorët; -ka bërë kërkime ligjore, në ndihmë të prokurorëve në gjetjen e legjislacionit të nevojshëm, të praktikës gjyqësore, literaturës apo materialeve të tjera të nevojshme në zgjidhjen e një çështjeje konkrete; ka përpiluar drafte akteve për rastet e trajtuara lidhur me konfliktet e kompetencës mes prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, të caktuara nga drejtori i drejtorisë; - si dhe detyra të tjera që i janë ngarkuar nga Prokurori i Përgjithshëm apo drejtori i drejtorisë.

Nga verifikimi të dhënave rezulton se për periudhën që ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore nuk ka vlerësim të punës nga titullari dhe nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore.”

44. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si Këshilltar në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, me shkresën nr. 610/1 prot., datë 19.02.2025, Kuvendi ka bërë me dije KED se, përcjell informacionin e kërkuar si vijon: “...1. Aktin e emërimit pranë Institucionit të Kuvendit të Shqipërisë; 2. Aktin e lirimit nga

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Shërbimi Civil i Kuvendit të Shqipërisë; 3. Formularët e vlerësimit të punës për periudhën e punësimit në Kuvendin e Shqipërisë; 4. Vërtetimi për masat disiplinore.” Bashkëlidhur shkresës së mësipërme gjendet vërtetimi nr. 19 prot., datë 19.02.2025 i Kuvendit, sipas të cilit “...znj. Alma Hakik Faskaj ka qenë nëpunëse e Administratës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në pozicionin "Këshilltare" në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit. Për periudhën e punësimit në administratën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 01.04.2014-19.06.2017, nuk ka pasur asnjë masë disiplinore që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.” Konstatohet se Kuvendi ka vënë në dispozicion praktikë dokumentare që i referohet periudhës së punësimit të kandidatit pranë Kuvendit, duke përfshirë si vijon:

- Vendimin nr. 30, nr. 795/1 prot., datë 27.03.2014 “Për emërimin e një nëpunësi civil në administratën e Kuvendit”, të Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm me të cilin është vendosur: *“1. Të emëroj, në shërbimin civil të Kuvendit zonjën Alma FASKAJ VOKOPOLA, në detyrën "këshilltar", në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, për një periudhë prove 1 vjeçare. Gjatë kësaj periudhe ajo është nën kujdesin e Z. Endrit Picoka dhe do të vlerësohet nga eprori direkt i saj. 2. Marrëdhëniet e saj financiare me Kuvendin do të fillojnë në datën 01.04.2014. Paga e saj mujore do të jetë sipas klasës II, kategorisë II-b, të tabelës së pagave të punonjësve të Kuvendit dhe Lidhjes nr.1, të Vendimit të KM, nr.589, datë 17.07.2013. Paga e grupit është 14 000 lekë. Vjetërsia në punë e saj është 16 vjet.”*
- Vendimin nr. 1320 prot., datë 07.04.2015, të Kuvendit, Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit, me të cilin është vendosur: *“1- Konfirmimin "nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese", të znj. Alma VOKOPOLA FASKAJ, në detyrën "këshilltar", në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit.”;*
- Aktin “Për deklarimin e statusit Nëpunës Civil”, nr. 13201 prot., datë 09.04.2015 me të cilin është deklaruar statusi “nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese” Alma Faskaj, nëpunës në administratën e Kuvendit, në detyrën “Këshilltar”, në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit.
- Kërkesë datë 17.06.2017 e Alma Faskaj për pezullimin e statusit të nëpunësit civil për shkak se është zgjedhur anëtare e Komisionit të Pavarur të Apelit;
- Vendim nr. 17, datë 19.06.2017 i Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm “Për pezullimin nga shërbimi civil të Alma Faskaj Vokopola”, për periudhën e emërimit në detyrën e anëtares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërsa marrëdhëniet financiare ndërpriten në datë 19.06.2017.
- Vlerësime pune nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ku është vlerësuar “shumë mirë” (me përjashtim të periudhës 27.03.2014-26.03.2015 ku nuk ka shënim);

44.1 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr. 1408/1 prot., datë 23.04.2025, ka paraqitur pranë KED vërtetimin nr. 18 prot., datë 18.04.2025, sipas të cilit rezulton se, *“...Alma Hakik Faskaj ka qenë nëpunëse e Administratës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në pozicionin "Këshilltare" në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit. Për periudhën e punësimit në administratën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 01.04.2014-19.06.2017, nuk ka pasur asnjë masë disiplinore.”*

45. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si Komisioner (Anëtar), Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me shkresën nr. 1408/1 prot., datë 23.04.2025 ka bërë me dije KED se,

“I- Në lidhje me vijueshmërinë e marrëdhënies së punës në funksionet e ushtruara: 1. Znj. Alma Hakik Faskaj, e datëlindjes 21.08.1973, identifikuar me nr. personal H35821075Q (ish komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit 2017-2024).

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

1.1 Znj. Alma Faskaj është zgjedhur në funksionin e anëtares në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me vendimin nr.82 të Kuvendit të Shqipërisë, datë 17.6.2017, "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

1.2 Bazuar në nenin 179/b, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: "Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024...", mandati znj. Alma Faskaj ka përfunduar më 31.12.2024.

II. Në lidhje me masat disiplinore: Duke qenë se të gjithë kandidatët e mësipërm kanë ushtruar funksione si anëtarë të institucioneve të rivlerësimit, bazuar në nenin 17, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", masat disiplinore ndaj anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit jepen nga një komision disiplinor me 3 gjyqtarë të Kolegjit të Apelit. Në këto kushte, për çështjet që kërkojnë për këtë pikë duhet t'i drejtoheni Kolegjit të Apelit." Bashkëlidhur kësaj shkresë është paraqitur dokumentacion si: vendimi nr. 82/2017 i Kuvendit të Shqipërisë, "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; vërtetim i lëshuar nga Shërbimi Administrativ/ Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë për znj. Alma Hakik Faskaj, për periudhën e punësimit në Administratën e Kuvendit të Shqipërisë, 01.04.2014 19.06.2017.

46. Ndërsa, Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. 592/1 prot., datë 06.05.2025, ka bërë me dije KED se, "... në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor, në kuadër të parashikimit të nenit 17, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe, si rrjedhojë, nuk rezulton të ketë masë disiplinore gjatë vijueshmërisë së marrëdhënies së punës për ish-Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Alma Faskaj, Gjithashtu, në funksion të veprimtarisë suaj në vijim, ju informojmë se nga Kolegji nuk është filluar/marrë masë disiplinore për asnjë nga ish-anëtarët e dy institucioneve të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë, gjatë vijueshmërisë së marrëdhënies së tyre të punës,"

47. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Universitetit Jo Publik "Justizia" dhe "Justiniani", si pedagog i jashtëm, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit me shkresën nr. 2850/1 prot., datë 14.05.2025, ka bërë me dije KED se, "MAS nuk posedon informacion në lidhje me punësimin e znj. Alma Faskaj." Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Drejtoria e Shërbimeve Arkivore me shkresën nr. 4728/1 prot., datë 06.05.2025 ka bërë me dije KED se, "Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. 218 prot., datë 30.04.2025, lidhur mbi të dhëna punësimi si pedagog e jashtëm pranë Institucionit të Arsimit të Lartë "Justiniani I" dhe "Justicia", në emër të Alma Hakik Faskaj, ju bëjmë me dije se pranë Arkivit Qendror Shtetëror për këto institucione, disponojmë vetëm regjistrat e amzave dhe notave dhe jo dokumentacion administrativ." Sipas dokumentacionit të paraqitur nga kandidata në kohën e aplikimit, vërtetimit datë 06.02.2017 të Shkollës së Lartë Jopublike "Justicia", rezulton si lektore në lëndët e të drejtës administrative, për periudhën kohore 01.10.2007-30.07.2012.

48. Lidhur me marrëdhënien e punësimit dhe veprimtari profesionale të kandidatit, KED ka kërkuar informacion me shkresat nr. 216 prot., datë 30.04.2025 dhe nr. 241 prot., datë 28.05.2025 Universitetit "Luarasi" (lidhur me veprimtarinë e mësimdhënies si pedagog e jashtëm). Lidhur me veprimtarinë e mësimdhënies pranë Universitetit "Luarasi", sipas vërtetimit datë 08.02.2017 të Kolegjit Universitar Luarasi, të paraqitur nga kandidati në kohën

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

e aplikimit, rezulton si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë të këtij Universiteti, nga viti 2004 deri në vitin 2012, në lëndën e të drejtës administrative.

49. Lidhur me marrëdhënien e punësimit dhe veprimtari profesionale të kandidatit, KED ka kërkuar informacion me shkresën nr. 240 prot., datë 28.05.2025, Shkollës së Magjistraturës (për veprimtarinë e mësimdhënies si lektore/pedagoge e jashtme). Lidhur me veprimtarinë e mësimdhënies të kandidatit pranë Shkollës së Magjistraturës, si pedagog i jashtëm, Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. 782/1 prot., datë 09.6.2025, ka bërë me dije KED se,

“Znj. Alma Faskaj është angazhuar pranë Shkollës së Magjistraturës në Programin e Formimit Fillestar, si pedagoge e jashtme në lëndën “E drejtë administrative” dhe si asistent pedagoge në lëndën “Ndërmjetësim Arbitrazhi”, lëndë të cilat zhvillohen gjatë vitit të parë. Gjithashtu, ajo është miratuar edhe si specialiste në kursin e vitit të dytë çështjet që lidhen me fushën administrative.

Me vendimin nr. 43, datë 17.9.2015, “Për miratimin e pedagogëve të jashtëm për vitin e parë akademik 2015-2016” është miratuar si pedagoge e jashtme në lëndën e drejtë administrative, dhe ka zhvilluar 9 orë mësimore.

Me vendimin nr. 17, datë 21.12.2016, “Për miratimin e planit dhe programit mësimor të vitit të parë dhe listës së pedagogëve/specialistëve të jashtëm për vitin akademik 2016-2017” është miratuar si pedagoge e jashtme në lëndën e të drejtës administrative dhe ka zhvilluar 8 orë mësimore.

Me vendimin nr. 22, datë 21.7.2017, “Për miratimin e listës së pedagogëve të vitit të parë sipas lëndëve përkatëse të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2017-2018” është miratuar si pedagoge e jashtme në lëndën e të drejtës administrative dhe ka zhvilluar 3 orë mësimore.

Me vendimin nr. 26, datë 24.9.2018, “Për miratimin e planeve dhe programeve mësimore në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2018-2019”, pika 3, si pedagoge e jashtme në lëndën e drejtë administrative dhe si specialiste në kursin e vitit të dytë çështjet që lidhen me fushën administrative.

Nga viti akademik 2020-2020 deri në vitin akademik 2022-2023 zonja Faskaj është miratuar si asistent pedagoge në lëndën e ndërmjetësim arbitrazhit, por nuk është angazhuar në mësimdhënie.

Me vendimin nr. 33, datë 22.9.2020, “Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2020-2021” si asistent pedagoge në lëndën e ndërmjetësim arbitrazhit.

Me vendim nr. 28, datë 23.9.2021, “Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2021-2022”, është miratuar si asistent pedagoge në lëndën e ndërmjetësim arbitrazhit.

Me vendim nr. 29, datë 27.9.2022, “Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2022-2023”, është miratuar si asistent pedagoge në lëndën e ndërmjetësim arbitrazhit.

Në vlerësimet e dhëna nga kandidatët për magistratë të vitit të parë znj. Alma Faskaj është vlerësuar shumë mirë dhe shkëlqyeshëm.”

49.1 Gjithashtu me të njëjtën shkresë, Shkolla e Magjistraturës ka bërë me dije KED se kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka marrë pjesë në rolin e ekspertit apo lehtësuesit në aktivitetet trajnuese, si vijon:

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Aktivitetit trajnues me temë “Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDA^E). Roli i gjykatës dhe i sistemit të drejtësisë”, datë 24 - 25 tetor 2016, në rolin “Lehtësuese”;
- Aktivitetit trajnues me temë “Kudri ligjor mbi të drejtat e grupeve të marginalizuara me fokus tek gratë dhe vajzat. Konventa e Stambollit mbi dhunën në familje dhe roli i sistemit të drejtësisë.”, datë 31 tetor 2016 - 1 nëntor 2016, në rolin “Eksperte”;
- Aktivitetit trajnues me temë “Risitë që sjell Kodi i ri i Procedurave Administrative në krahasim me Kodin e mëparshëm. Ligjshmëria e aktit administrativ; paligjshmëria dhe pavlefshmëria absolute; Mjetet e ankimit dhe të rishikimit të akteve administrative; Ankimi administrativ; kundërshtimi dhe rishikimi; Anulimi dhe shfuqizimi. Elementët e përbashkët dhe të veçantë të gjykimit administrativ dhe kushtetues.”, datë 2-3 shkurt 2017, në rolin “Eksperte”.
- Aktivitetit trajnues me temë “Dimensioni i ri i aksesit dhe bashkëpunimit të individit me institucionet e drejtësisë. Gjykimi kushtetues i kërkesave individuale dhe shqyrtimi i informacioneve dhe kërkesave të qytetarëve nga organet e pushtetit gjyqësor.”, datë 6-7 korrik 2017, në rolin “Eksperte”.

50. Lidhur me marrëdhënien e punësimit dhe veprimtari profesionale të kandidatit, KED ka kërkuar informacion me shkresën nr. 242 prot., datë 28.05.2025, Institutit të Sigurimeve Shoqërore (për periudhën e punësimit pranë Këshillit të Rrethit Lushnje 1995-1996 dhe periudhën e punësimit 2004-2017 nëse janë derdhur kontributet dhe personin juridik/fizik (punëdhënës). Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 5591/1 prot., datë 04.06.2025 ka bërë me dije KED se, “Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron të dhëna për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat mblidhen dhe dërgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet webService, të dhëna të cilat i disponojmë nga viti 2012 e në vazhdim. Për sa më sipër, lutemi të gjeni bashkëlidhur informacionin e kërkuar për periudhën 01.01.2012 e deri në muajin sipas formularit bashkëlidhur për shtetasen, Alma Hakik Faskaj me ID H35821075Q.” Konstatohet se bashkë me këtë informacion është paraqitur si dokumentacion vërtetim për bazën e vlerësuar datë 02.06.2025 për kandidatin Alma Faskaj, nga i cili rezulton pagesa e kontributeve për periudhat si vijon:

Janar 2012 – Prill 2014, janë derdhur kontributet nga Prokuroria e Përgjithshme (për pozicion pune Këshilltar ligjor);

Janar 2012 – Dhjetor 2012, janë derdhur kontributet nga Shkolla e Lartë Universitare JoPublike (për pozicion pune Pedagog);

Janar 2013 – Tetor 2014 janë derdhur kontributet nga Universiteti Luarasi (për pozicion pune Pedagog);

Prill 2014 – Qershor 2017, janë derdhur kontributet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (për pozicion pune Këshilltar);

Qershor 2017 – Dhjetor 2024, janë derdhur kontributet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (për pozicion pune gjyqtar);

Prill 2016; Qershor 2016; Nëntor 2016; Prill 2017; Maj 2017; Korrik 2017; Dhjetor 2018 janë derdhur kontributet nga Shkolla e Magjistraturës (për pozicion pune pedagog).

50.1 Ndërsa me shkresën nr. 5591/2 prot., datë 4.6.2025 drejtuar Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije KED se, “Për sa më sipër, Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore të përpunojë informacionin e kërkuar lidhur me të dhënat e historikut kontributiv për periudhën para vitit 2012 dhe të dërgojë pranë “Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, informacionin e plotë për të gjithë periudhën ku rezultojnë të paguara kontributet për sigurimet shoqërore.” Drejtoria e Arkivit Qendror, me

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

shkresën nr. 4245/1 prot., datë 13.06.2025 ka bërë me dije KED se, *nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 – 2012 të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore juridik apo fizik nuk mund të konfirmojnë periudha kontributive apo paga mbi të cilat këta subjekte janë siguruar nëqoftë se nuk jepet dokumentacioni përkatës nga ana e subjektit kërkuar lidhur me emërtimin e qendrës së punës, nipt-in e subjektit, fotokopje e librezës së punës.*

51. Me shkresën nr. 246 prot., datë 03.06.2025, KED ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme mbi mënyrën e rekrutimit dhe klasifikimin e pozicionit të punës së kandidatit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas legjislacionit të kohës së ushtrimit të detyrës (kategoria/klasa/pozicioni), institucion i cili me shkresën nr. 274/5 prot., datë 16.06.2025 bën me dije KED se, *“1. Mbi bazën e kërkesës së saj, me Urdhërin nr.211, datë 02.12.2011, të Prokurorit të Përgjithshëm, znj. Alma Faskaj, është emëruar në detyrën e Ndhmësit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme. 2. Me shkresën nr.3824 prot., datë 05.12.2011, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, ka njoftuar Degën e Finances për emërimin e znj. Alma Faskaj në detyrën e Ndhmëses Ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, barazuar me pagën për nënpunësin civil të kategorisë III-a. Bashkëlidhur ju dërgojmë një kopje të Urdhërit nr.211, datë 01.12.2011 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe shkresës nr.3824 prot., datë 05.12.2011.”* Konstatohet se bashkë me këtë informacion është paraqitur si dokumentacion urdhri nr. 211, datë 02.12.2011 i Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin e Alma Faskaj në detyrën e ndhmësit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe shkresë nr. 3824 prot., datë 5.12.2011 i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme sipas të cilës ndhmësit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a.

52. Me shkresën nr. 247 prot., datë 03.06.2025, KED ka kërkuar informacion pranë Avokatit të Popullit, mbi klasifikimin e pozicionit të punës së kandidatit (Ndhmëskomisioner dhe Këshilltar) pranë Avokatit të Popullit, sipas legjislacionit të kohës së ushtrimit të detyrës (kategoria/klasa/pozicioni), i cili me shkresën nr. 360/1 prot., datë 10.06.2025 bën me dije KED se,

“Znj. Alma (VOKOPOLA) FASKAJ për periudhën 16.08.2000 deri më 31.12.2000, me urdhërin nr. 211, datë 16.08.2000, është emëruar "Ndhmëskomisioner" në institucionin e Avokatit të Popullit, me pagë pozicioni në shumën prej 45,980 (dyzet e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë, kategoria B-3, klasa 2. Ky pozicion ka qenë ekuivalent me pozicionin Drejtor Drejtorie, bazuar në VKM-në nr. 378, datë 14.07.2000, dhe më tej me VKM-n nr. 500, datë 18.07.2003 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit".

Për periudhën 01.05.2001 deri më 31.12.2011, znj. Alma (VOKOPOLA) FASKAJ me urdhërin nr. 220, datë 19.04.2000, është emëruar "Këshilltar" i Avokatit të Popullit, me pagë pozicioni në shumën prej 56,870 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë, kategoria I-B, klasa 1. Ky pozicion ka qenë ekuivalent me pagën e Sekretarit të Përgjithshëm në ministri, Drejtorit të Departamentit në KM etj, referuar lidhjes 4 të VKM nr.545, datë 11.08.2011, e më tej me VKM nr. 500, datë 18.07.2003 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit".

53. Në datë 30.05.2025, KED i ka bërë me dije kandidatin në rrugë elektronike, të drejtën për të përcjell parashtrime me shkrim dhe shpjegime, brenda një afati 5 ditor si dhe nëse vlerësohet e nevojshme të dokumenteve mbështetës, lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë së tij profesionale me kërkesat e nenit 7/a, pika 2 e Ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe pikës 97/1 të vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të KED, i ndryshuar. Gjithashtu, duke qenë se nga shqyrtimi i jetëshkrimit ka rezultuar se është shënuar si përvojë profesionale: *Nënkryetare e Komisionit Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Lushnjë, pranë Këshilli i Rrethit, Komisioni i Kthimit dhe Kompesimi të Pronave Lushnjë për periudhën Shtator 1995 – Gusht 1998*; ndërkohë sipas librezës së punës përvoja profesionale rezulton: *Juriste pranë Këshillit të Rrethit Lushnje për periudhën 09.12.1996-31.07.1998*, Këshilli ka kërkuar sqarime dhe dokumentacion mbështetës, edhe lidhur me këtë konstatim.

54. Brenda afatit të caktuar nga relatorja, në datë 04.06.2025, kandidati ka depozituar në rrugë elektronike parashtrime me shkrim, si dhe dokumentacion mbështetës. Kandidati ka vlerësuar se plotëson kriterin ligjor të përvojës profesionale sipas ligjit. Në datë 05.06.2025, parashtrimet e kandidatit dhe provat bashkëlidhur i janë dërguar anëtareve të Këshillit.

55. Për sa më lart, në zbatim të pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton i provuar fakti se kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka vjetërsi pune mbi 29 vite në administratë publike, brenda sistemit gjyqësor dhe në organe kushtetuese, për periudhat e saktësuara si më poshtë:

1. 09.12.1996 - 31.07.1998, Juriste pranë Këshillit të Rrethit Lushnje, *1 (një) vit, 7 (shtatë) muaj, 22 (njëzet e dy) ditë*;
2. 01.08.1998 - 15.08.2000, Asistent pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, *2 (dy) vjet e 14 (katërmëdhjetë) ditë*;
3. 16.08.2000 - 01.05.2001, Ndihmëskomisioner pranë Avokatit të Popullit, *8 (tetë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë*;
4. 01.05.2001 - 05.12.2011, Këshilltar pranë Avokatit të Popullit, *10 (dhjetë) vjet, 7 (shtatë) muaj e 4 (katër) ditë*;
5. 05.12.2011-01.04.2014, Ndihmës Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, *2 (dy) vjet, 3 (tre) muaj e 27 (njëzet e shtatë) ditë*;
6. 01.04.2014 – 17.06.2017, Këshilltar në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit (Kuvendi), *3 (tre) vjet, 2 (muaj) e 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë*;
7. 17.06.2017 - 31.12.2024, Komisionere pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, *7 (shtatë) vjet, 6 (gjashtë) muaj e 14 (katërmëdhjetë) ditë*.

55.1 Gjithashtu, kandidati ka ushtruar veprimtari mësimdhënëse pranë Shkollës së Magjistraturës si pedagog e jashtme (për vitet akademike 2015-2016 - 9 orë mësimore, 2016 – 2017 - 8 orë mësimore, 2017 – 2018 - 3 orë mësimore).

IV. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

56. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidatit Alma Faskaj (Vokopola) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024.

57. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :
“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj”.

58. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

59. Përsa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI ka përcjell aktin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, Alma Faskaj (Vokopola) për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, me shkresën nr. 16/23 prot, datë 08.05.2025, ku është konkluduar për kandidatin Alma Faskaj (Vokopola).

60. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,

b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,

c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë,

d) nuk ka kryer deklarim të rremë,

e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave

61. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli i rezulton se, nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklarin e bëra nga kandidati Alma Faskaj (Vokopola) pranë ILDKPKI me Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

62. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola).

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : ***GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : ***info@ ked.gov.al*** Numra telefonikë : ***+355 4 2257302***

63. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

64. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

65. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 206/04 prot., datë 12.02.2025, ka bërë me dije, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se: *“...nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik IMPRO.... i cili përmban të dhëna nga viti 2015 e në vazhdim për shtetasit e tjerë të cituar në shkresën tuaj, nuk rezulton asnjë praktikë e regjistruar në sistemin IMPRO”*.

66. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, në vijim të shkresës së saj nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025 me shkresën nr. 206/19 prot., datë 07.03.2025, ka përcjellë në KED vendimin e datës 07.03.2025 *“Për mospranimin e kërkesës për verifikim”*, të të dhënave të plotësuara në zbatim të ligjit nr. 138/2015, në formularin e vetëdeklarimit datë 22.01.2025 për kandidatin Alma Faskaj (Vokopola).

67. Në lidhje me këtë kandidat, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dërguar me shkresën nr. 70 prot., datë 31.01.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 1616/1 prot., datë 07.02.2025, ka informuar se: *“...rezultojnë pa shënime në sistem...”*.

68. Gjithashtu Prokuroria e Përgjithshme, ka përcjell shkresën nr. 206/44 prot., datë 29.04.2025, lidhur me të gjithë informacionin e ardhur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore me Juridiksion të Përgjithshëm, ku në thelb rezulton se: *“.... nuk rezulton të kenë çështje penale në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë...”*.

69. Në lidhje me këtë kandidat, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dërguar me shkresën nr. 73 prot., datë 31.01.2024, Drejtoria e Përgjithshme të Gjendjes Civile e cila me shkresën nr. 1166/1 prot., datë 12.02.2025, ka kthyer përgjigje se: *“ka ndryshuar mbiemrin nga Vokopola në Faskaj me martesë”*.

70. Në lidhje me këtë kandidat, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dërguar me shkresën nr. 68 prot., datë 31.01.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 543/4 prot., datë 10.02.2025, ka informuar se: *“Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasit.... nuk janë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga strukturat e Policisë së Shtetit për kryerjen e ndonjë vepre penale; nuk figurojnë të regjistruar me identitet tjetër; nuk rezultojnë të kthyer deportiv apo të dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër; nuk rezulton të kenë urdhër kërkimi ndërkombëtar nga ndonjë autoritet gjyqësor i huaj”*.

71. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresat nr. 75 prot., - nr. 91 prot., datë 31.01.2025, ka kërkuar informacion pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Lartë, të cilat me shkresa respektive kanë referuar në thelb se, *“nuk rezulton që të ketë të regjistruar çështje penale në emër të shtetasit Alma Faskaj Vokopola”*.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : ***GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : ***info@ ked.gov.al*** Numra telefonikë : ***+355 4 2257302***

72. Në vijim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. 71 prot., datë 31.01.2025, i ka kërkuar informacion dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim SPAK), e cila, me shkresën nr. 7717 prot., datë 28.02.2025, ka kthyer përgjigje se:

“ ... ju konfirmojmë se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e procedimeve penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të kandidatëve të mëposhtëm, të cilët do të përfshihen në shortin për zgjedhjen si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese: ... Alma Hakik Faskaj, datëlindja 21.08.1973, nr. personal H35821075Q. ...

Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e kallëzimeve të veprave penale të të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ju informojmë se ...

Në lidhje me shtetasen Alma Faskaj, rezultojnë këto të dhëna:

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallzimi Nr. 107, i vitit 2020, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr. 160, viti 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 186, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar. Pas përfundimit të hetimeve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin Nr.28, datë 11.02.2021, ka vendosur pushimin e procedimit Nr. 160, viti 2020.

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallzimi Nr.72, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.03.2021.

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallzimi Nr.272, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 14.09.2021. ...”

73. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në vijim të informacionit shtesë të kërkuar nga KED (lidhur me faktin nëse është ushtruar ankim ndaj vendimeve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për mosfillimin e procedimit penal datë 29.03.2021 (për kallëzimin nr. 72/2021) dhe datë 14.09.2021 (për kallëzimin nr. 272/2021), me shkresën nr. 13137 prot., datë 16.04.2025, ka bërë me dije KED se:

“Në lidhje me shtetasen Alma Faskaj, rezultojnë këto të dhëna:

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallëzimi Nr.107, i vitit 2020, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr. 160, viti 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 186, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar. Pas përfundimit të hetimeve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin Nr.28, datë 11.02.2021, ka vendosur pushimin e procedimit Nr. 160, viti 2020.

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallëzimi Nr.72, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.03.2021. Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses. Me vendimin Nr.123 datë 03.06.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit të kallëzueses. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e cila me vendimin Nr.177, datë 21.07.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr.123 datë 03.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Ndaj shtetases Alma Faskaj, është regjistruar kallëzimi Nr.272, i vitit 2021. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 14.09.2021.

Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Me vendimin Nr.352 datë 25.10.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur me vendimin Nr.disponimi 267, datë 22.12.2021. Nga ana e kërkuarit është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin Nr.00-2022-482, datë 12.04.2022, ka vendosur prishjen e vendimit Nr.267, datë 22.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur miratimin e vendimit Nr.352, datë 25.10.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”

74. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

75. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, pas kontrollit të ushtruar, me shkresën nr. 222/3 prot., datë 14.02.2025, ka përcjellë, në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 71, datë 13.02.2025, me të cilën është konkluduar se: “.... Për znj. Alma Faskaj (Vokopola), nga verifikimet e kryera deri tani, bazuar në përcaktimet e nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar rezulton se: 1. Nuk kanë qenë persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; 2. Nuk kanë qenë bashkëpunëtor anëtar ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit. 3. Nuk figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, deri në 2 korrik 1991, sipas përcaktimeve të Nenit 29, pika 2 Ligjit Nr.45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar. ...”.

76. Nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se kandidati Alma Faskaj (Vokopola), krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

77. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar sot Autoriteti Kombëtar Për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, sot Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, nëse kandidati Alma Faskaj (Vokopola) “ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

78. Autoriteti Kombëtar Për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 1345 prot., datë 12.03.2025 ka evidentuar se: *“Në përfundim të procedurave të verifikimit, autoritetet verifikuese na informojnë se nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e znj. Alma Hakik Faskaj, në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme. Për kandidaten e lartpërmendur, janë aplikuar standardet e parashikuara në nenin 38 "Standardet e kontrollit të figurës, të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

79. Ndërsa, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, sot Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, me shkresën nr. 658/1 prot., datë 11.02.2025, ndër të tjerë, për kandidatin Alma Faskaj (Vokopola) ka informuar se: *“Nuk ka të dhëna për kontakte apo lidhje të tyre me persona të papërshtatshme, apo të përfshirë në krimin e organizuar”.*

80. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

81. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Alma Faskaj (Vokopola) në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet ku kandidati ka ushtruar funksione publike.

82. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Alma Faskaj (Vokopola), ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë në periudhën 1991-1995, duke u diplomuar “Jurist”, në datë 11.07.1995. Në zbatim të neneve 75 dhe 124 të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Në aktet e administruara në dosjen e kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), ka rezultuar i provuar fakti se, kandidati ka kryer studime pasuniversitare në programin “Master në Shkencat Juridike në të drejtë Publike” pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Publike, në periudhën 2002-2006 dhe në datë 08.07.2011, ka mbrojtur mikrotezën me temë *“Procedimi administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërië”*. Gjithashtu, në aktet e administruara në dosjen e kandidatës kandidati ka kryer studime doktorature pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dhe ka fituar gradën shkencore “Doktor” në të drejtën publike (disertacion me temë *“Procedimi administrativ në Republikën e Shqipërisë”*), me nr. 828 diplome, datë 09.06.2014.

83. Në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : ***GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : ***info@ked.gov.al*** Numra telefonikë : ***+355 4 2257302***

punës, shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Alma Faskaj (Vokopola), ka ushtruar veprimtari profesionale si:

09.12.1996 - 31.07.1998, Juriste pranë Këshillit të Rrethit Lushnje, *1 (një) vit, 7 (shtatë) muaj, 22 (njëzet e dy) ditë*;

01.08.1998 - 15.08.2000, Asistent pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, *2 (dy) vjet e 14 (katërmëdhjetë) ditë*;

16.08.2000 - 01.05.2001, Ndhmëskomisioner pranë Avokatit të Popullit, *8 (tetë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë*;

01.05.2001 - 05.12.2011, Këshilltar pranë Avokatit të Popullit, *10 (dhjetë) vjet, 7 (shtatë) muaj e 4 (katër) ditë*;

05.12.2011-01.04.2014, Ndhmës Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, *2 (dy) vjet, 3 (tre) muaj e 27 (njëzet e shtatë) ditë*;

01.04.2014 – 17.06.2017, Këshilltar në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit (Kuvendi), *3 (tre) vjet, 2 (muaj) e 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë*;

17.06.2017 - 31.12.2024, Komisionere pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, *7 (shtatë) vjet, 6 (gjashtë) muaj e 14 (katërmëdhjetë) ditë*.

83.1 Gjithashtu, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka ushtruar veprimtari mësimdhënëse pranë Shkollës së Magjistraturës si pedagog e jashtme (për vitet akademike 2015-2016 - 9 orë mësimore, 2016 – 2017 - 8 orë mësimore, 2017 – 2018 - 3 orë mësimore). Gjithashtu, sipas dokumentacionit të paraqitur në kohën e aplikimit, kandidati ka ushtruar veprimtari mësimdhënëse pranë Shkollës së Lartë Jopublike “Justicia”, për periudhën 01.10.2007-30.07.2012 dhe si pedagog e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti “Luarasi”, për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2012, ndërsa sipas dokumentacionit të administruar nga ISSH, edhe për periudhën Janar 2013 – Tetor 2014.

84. Sa i përket përvojës profesionale të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se është në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 7/a, pika 2 të ligjit nr. 8577/2000, ku përcaktohet që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar.

85. Sa i përket përvojës profesionale të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), si ndihmës komisioner pranë Avokatit të Popullit, Këshilli çmon këtë përvojë profesionale të vlefshme për efekt kandidimi.

86. Bazuar në të dhënat zyrtare të konfirmuara nga institucioni përkatës konstatohet se, kandidatja ka ushtruar funksionin e “Ndhmëskomisionerit” pranë Avokatit të Popullit, në periudhën 16.08.2000 – 01.05.2001. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga kandidatja në vijim të parashtrimit të mësipërm për periudhën 16.08.2000 deri më 31.12.2000, kandidatja Alma Faskaj (Vokopola), si "Ndhmëskomisionere" në institucionin e Avokatit të Popullit me pagë bruto për këtë periudhë, shumën 216.910 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dhjetë) lekë, kategoria B-3, ekuivalent me pozicionin Drejtor i Përgjithshëm.

87. Ndërsa, me shkresën nr. 360/1 prot., datë 10.06.2025 Avokati i Popullit bën me dije KED se, “Znj. Alma (VOKOPOLA) FASKAJ për periudhën 16.08.2000 deri më 31.12.2000, me urdhërin nr. 211, datë 16.08.2000, është emëruar "Ndhmëskomisioner" në institucionin e Avokatit të Popullit, me pagë pozicioni në shumën prej 45,980 (dyzet e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë, kategoria B-3, klasa 2. Ky pozicion ka qenë ekuivalent me pozicionin Drejtor Drejtorie, bazuar në VKM-në nr. 378, datë 14.07.2000, dhe më tej me VKM-n nr. 500, datë 18.07.2003 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit". Për sa i përket detyrës funksionale dhe natyrës së punës në pozicionin e “Ndhmëskomisionerit”, bazuar në të dhënat zyrtare të konfirmuara nga institucioni përkatës

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

kandidatja ka trajtuar ankesat për fushat administrative, gjyqësore, strehimit dhe pronësisë, duke realizuar ndjekjen e rasteve dhe përgatitjen e rekomandimeve.

88. Ndërkohë, sipas rregullores së brendshme të punës “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit” miratuar me urdhërin nr. 1, datë 3.10.2000 të Avokatit të Popullit, neni 11 parashikohet se, *“Ndihmës komisioneri vepron në kuadrin e seksioneve të specializuara, nën drejtimin e komisionerit dhe duhet të zbatojë me përpikmëri urdhërat, udhëzimet dhe porositë që i jepen në vijë vertikale, sipas shkallës hierarkike nga varet. Ndihmëskomisioneri duhet të zbatojë në punën e tij metodologjinë e përcaktuar nga Avokati i Popullit për pranimin dhe zgjidhjen e kërkesave apo ankesave të individëve, grupit të individëve ose organizatave joqeveritare.”*

89. Ndërsa, sipas rregullores së miratuar me urdhërin nr. 129, datë 17.06.2022 të Avokatit të Popullit, “Ndihmëskomisioneri” ka përgjegjësi lidhur me trajtimin, shqyrtimin, verifikimin dhe inspektimin e problematikave që evidentohen nga ankesat, kërkesat e çdo individ apo grupi individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të rasteve me iniciativë dhe inspektimeve të veçanta apo periodike. (neni 7). Detyrat kryesore të ndihmëskomisionerit, ndër të tjera janë: *Të njohë në thellësi legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, për fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe në veçanti për fushën përkatëse që mbulon, si dhe të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm me legjislacionin e sipërpërmendur, por edhe me standardet më të larta të promovimit, mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut; Të jetë i përditësuar me praktikën e GJEDNJ, ECJ, Gjykatës Kushtetuese si dhe të ketë njohuri të plota e të përditësuara në lidhje me raportimet e organizatave të të drejtave të njeriut sipas fushës së kompetencës; Të hartojë rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legjislative në rastet kur vetë ligji apo akti nënligjor përbën premisë për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; Të ndjekë dhe monitorojë zbatimin e rekomandimeve të paraqitura nga Avokatit i Popullit pranë organeve të administratës publike në kuadër të zgjidhjes së rasteve konkrete dhe mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individit; etj.*

90. Në ligjin nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil.” në nenin 11 dhe më pas në nenin 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit të punës. Konkretisht, pozicionet e nëpunësve civil ndahen në këto kategori: a) të lartë drejtues; b) të mesëm drejtues; c) të ulët drejtues; ç) ekzekutiv. Tek nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese përfshihen këto pozicione pune: a) sekretar i përgjithshëm; b) drejtor departamenti; c) drejtor drejtorie të përgjithshme; ç) pozicionet e barasvlershme me tre të parat.

91. Në kapitullin II, i titulluar “Klasifikimi”, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” (i ndryshuar), është parashikuar se: *“Klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë të jenë, si më poshtë vijon: Kategoria I - Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues Klasa Emërtimi i pozicionit 1 Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave, Presidencë, Kuvend dhe institucione të pavarura kushtetuese. 2 Sekretar i Përgjithshëm në ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj/drejtor departamenti/ titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës. 3 Sekretar i Përgjithshëm në qarqe, bashki, komuna, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj/titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës. (...)”*. Sipas lidhjes nr. 1 të VKM nr. 500, datë 18.7.2003 “Për miratimin

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”, paga e “Ndhmëskomisioner kategoria e parë” klasifikohet II-a, ndërsa “Ndhmëskomisioner kategoria e dytë Drejtor Drejtorie”, klasifikohet II-b. Ndërsa sipas VKM nr. 378, datë 14.7.2000 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 393, datë 3.9.1992 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, paga prej 45 980 lekë kategorizohet në nivelin B3.

92. Ndërsa në VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabinetit në disa institucione të Administratës Publike”, është parashikuar se: “1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen zëvendësministrit, funksionarët e kabineteve, prefekti, nënprefekti, nëpunësit civilë dhe nëpunësit (subjekte përfituese) në institucionet, si më poshtë vijon: a) Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, administratën e Kuvendit, administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Avokatin e Popullit, ...”; në pikën III, 6 të po kësaj VKM-je parashikohet se, “6. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.” Sipas lidhjes nr. 7 të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 ku parashikohen klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, paga e “Ndhmëskomisionerit” kategorizohet Klasa I-4 (Ndhmëskomisioner kategoria e parë) dhe klasa II-1 (Ndhmëskomisioner kategoria e dytë).

93. Përsa më lart, Këshilli çmon se kontributi profesional i kandidatit pranë një organi të pavarur si Avokati i Popullit, të parashikuar posaçërisht nga Kushtetuta, për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, referuar edhe llojit dhe natyrës së punës, është në përputhje me standardin e kërkuar nga neni 7/a, i ligjit nr. 8577/2000 “jurist i nivelit të lartë në administratën publike”.

94. Sa i përket përvojës profesionale të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), si Këshilltar pranë Avokatit të Popullit, Këshilli çmon këtë përvojë profesionale të vlefshme për efekt kandidimi.

95. Bazuar në të dhënat zyrtare të konfirmuara nga institucioni përkatës konstatohet se, kandidati ka ushtruar funksionin “Këshilltar” pranë Avokatit të Popullit, në periudhën 01.05.2001 - 05.12.2011. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga kandidatja në vijim të parashtrimit të mësipërm për periudhën 01.05.2001 deri më 31.12.2011, kandidatja Alma Faskaj (Vokopola), si “Këshilltar” në institucionin e Avokatit të Popullit me pagë bruto për këtë periudhë, shumën 503.260 lekë, kategoria I-B.

96. Detyrat funksionale pranë Avokatit të Popullit, për funksionin e Këshilltarit, sipas Rregullores të Brendshme të Punës, “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të avokatit të Popullit” miratuar me Urdhërin e Brendshëm nr. 1, datë 03.10.2000, sipas nenit 20, konsistonin në: *Shefi i Kabinetit së bashku me Këshilltarët dhe me Seksionin e specializuar bëjnë studime në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Shefi i Kabinetit dhe Këshilltarët i japin mendime Avokatit të Popullit dhe i sugjerojnë zgjidhje për problemet që Avokati i Popullit ngre përpara tyre si dhe për përsosjen e veprimtarisë së Institucionit po përsosjen e legjislacionit në përgjithësi.* Detyrat funksionale pranë Avokatit të Popullit, për funksionin e Këshilltarit, sipas Rregullores të Brendshme të Punës, miratuar me Urdhërin e Brendshëm nr. 64, datë 28.05.2008, sipas nenit 11, konsistonin në: *Jep mendime për projektligje apo drafte aktesh nënligjore që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe jep mendime për korrespondencën me natyrë juridike të Avokatiot të Popullit. Ndjek sipas*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

udhëzimit të dhënë nga Avokati i Popullit, marrëdhëniet e Institucionit me Kuvendin, Presidencën, Këshillin e Ministrave, Institucione të tjera të pavaruara me ministri të caktuara apo edhe me organe të tjera qëndrore apo vendore të administratës publike. Bënë pjesë në grupet e punës për përgatitjen dhe organizimin e veprimtarive kombëtare për gjendjen e të drejtave të njeriut, sipas përcaktimeve të bëra nga Avokati i Popullit. Harton dhe përgatit materiale të posaçme, në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të Kabinetit, për përmirësimin e procesit të punës dhe ia paraqit ato Avokatit të Popullit. Përfaqëson Institucionin në grupet e punës për përgatitjen e raporteve kombëtare për gjendjen e të drejtave të njeriut si dhe çdo aktivitet tjetër të këtij lloji, me autorizimin përkatës të Avokatit të Popullit. Bën pjesë në grupin e punës për hartimin e raportit vjetor që i paraqitet Kuvendit nga Avokati i Popullit, apo raporteve të veçanta që përgatiten për në Kuvend. Bashkëpunon me Komisionerët dhe Ndhimëskomisionerët në procesin e shqyrtimit të çështjeve të caktuara, sipas udhëzimeve të dhëna nga Avokati i Popullit. Në rastet kur Këshilltari trajton çështje konkretë individualisht, respekton të njëjtat rregulla siç bëjnë ndihmë komisionerët.

97. Në ligjin nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil.” në nenin 11 dhe më pas në nenin 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit të punës. Konkretisht, pozicionet e nëpunësve civil ndahen në këto kategori: a) të lartë drejtues; b) të mesëm drejtues; c) të ulët drejtues; ç) ekzekutiv. Tek nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese përfshihen këto pozicione pune: a) sekretar i përgjithshëm; b) drejtor departamenti; c) drejtor drejtorie të përgjithshme; ç) pozicionet e barasvlershme me tre të parat. Ndërsa në kapitullin II, i titulluar “Klasifikimi”, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” (i ndryshuar), është parashikuar se: “Klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë të jenë, si më poshtë vijon: **Kategoria I - Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues** **Klasa Emërtimi i pozicionit 1 Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave, Presidencë, Kuvend dhe institucione të pavarura kushtetuese. 2 Sekretar i Përgjithshëm në ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj/drejtor departamenti/ titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës. 3 Sekretar i Përgjithshëm në qarqe, bashki, komuna, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj/titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës.** Në mbështetje të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabinetit në disa institucione të Administratës Publike”, sipas lidhjes nr. 5, pozicioni dhe paga e “Këshilltarit të Avokatit të Popullit” kategorizohet Klasa I-3.

98. Ndërsa sipas shkresës nr. 360/1 prot., datë 10.06.2025 të Avokatit të Popullit drejtuar KED, mbi klasifikimin e pozicionit të punës së kandidates si Këshilltar pranë Avokatit të Popullit, sipas legjislacionit të kohës së ushtrimit të detyrës (kategoria/klasa/pozicioni), rezulton se: “Për periudhën 01.05.2001 deri më 31.12.2011, znj. Alma (Vokopola) Faskaj me urdhërin nr. 220, datë 19.04.2000, është emëruar “Këshilltar” i Avokatit të Popullit, me pagë pozicioni në shumën prej 56,870 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë, kategoria I-B, klasa I. Ky pozicion ka qenë ekuivalent me pagën e Sekretarit të Përgjithshëm në ministri, Drejtorit të Departamentit në KM etj, referuar lidhjes 4 të VKM nr. 545, datë 11.08.2011, e më tej me VKM nr. 500, datë 18.07.2003 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”.”

99. Përsa më sipër, Këshilli çmon se, kontributi profesional i kandidatit si këshilltar pranë një organi të pavarur si Avokati i Popullit, të parashikuar posaçërisht nga Kushtetuta, për të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, është në përputhje me standardin e kërkuar nga neni 7/a, i ligjit nr. 8577/2000 “jurist i nivelit të lartë në administratën publike”.

100. Sa i përket përvojës profesionale të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), si ndihmës ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Këshilli çmon këtë përvojë profesionale të vlefshme për efekt kandidimi. Lidhur me përvojën e punës si ndihmës ligjor, bazuar në natyrën e punës së kandidatit, si dhe referuar kuadrin ligjor në fuqi në kohën e ushtrimit të kësaj detyre⁴, si dhe rregullimeve ligjore aktualisht në fuqi⁵, Këshilli çmon se natyra e këtij pozicioni sipas ligjit të kohës barazohet me natyrën e punës së Ndihmësit Ligjor në Gjykatën e Lartë të asaj kohe dhe me natyrën e punës së Këshilltarit Ligjor jomagjistrat (sot) pranë Njësisë Ligjore të Prokurorisë së Përgjithshme, prandaj arrihet në përfundimin se, edhe kjo periudhë konsiderohet e vlefshme për plotësimin e kushtit formal të kandidimit.

101. Sa i përket përvojës profesionale të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), si Këshilltar në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshilli çmon se kjo përvojë profesionale është e vlefshme për efekt kandidimi. Bazuar në të dhënat zyrtare të konfirmuara nga institucioni përkatës konstatohet se, kandidati ka ushtruar funksionin “Këshilltar” në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit pranë Kuvendit, në periudhën 01.04.2014 - 17.06.2017⁶ (3 vjet, 2 muaj e 16 ditë). Nisur nga aktet e përcjella prej Kuvendit, konstatohet se me vendimin e datës 07.04.2015, me nr. 1320 prot., kandidati është konfirmuar si nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese në detyrë “këshilltar” në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

102. Sikurse rezulton nga shkresa nr. 1720 prot., datë 03.06.2025 e Kuvendit e paraqitur nga kandidati, si dhe parashtrimet e kandidatit, pjesë e fushës së përgjegjësisë së këshilltarit në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit janë: (i) *Të përgatisë mendimin e specializuar juridik të kërkuar nga Drejtori i Shërbimit të Përafrimit për çështje të përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit European (acquis e BE-së).* (ii) *Të përgatisë opinion ligjor për Kryetarin dhe anëtarët e komisionit të çështjeve europiane, për çdo projektligj, që i paraqiten Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, i cili synon përafrim me instrumentet ligjore të BE-së, duke dhënë mendimin e tij për: përputhshmërinë e tyre me acquis të BE-së, shkallën e përputhshmërisë së tyre me aktet ligjore të BE-së; përmirësim të përcaktimeve dhe formulimeve të propozuara (duke patur në konsideratë instrumentin ligjor të BE-së me të cilin synohet përputhshmëria).* (iii) *Të përgatisë opinion ligjor për Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për projekt- marrëveshjet që lidhen me institucionet e Bashkimit European dhe/ose me vendet e Bashkimit European, nëse projektligji nuk synon përafrim me legjislacionin e BE, por në fushëveprimin e tij ka acquis të BE-së.* (iv) *Të hartojë raporte përmbledhëse për ligjet e miratuara në Kuvend, që synojnë përafrimin me acquis e BE-së.* (v) *Të koordinojë me të gjitha Shërbimet e tjera të Kuvendit, për mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit të nevojshëm dhe përpunimin e tij, për hartimin e të gjitha kontributeve që kërkohen nga Kuvendi në kuadër të: i) takimeve të përbashkëta BE- Shqipëri (për zbatimin e MSA-së/ nënkomiteteve BE-Shqipëri/Drejtësi, Liri dhe Siguri (JFS); Kapitulli 23;. ii) të gjitha raportimeve apo hartimit të dokumenteve që kërkohen në kuadër të procesit të negociatave, ku*

⁴ Ligji nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin Nr.10 051, datë 29.12.2008.

⁵ Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 42/2021.

⁶ Sipas vërtetimit të institucionit deri në datë 19.06.2017.

Kuvendi është në pozicionin e institucionit raportues (Kapitulli 23, Kriterin Politik etj); iii) Planit Kombëtar të Integritetit Europian (PKIE); iv) Agjencisë për të Drejtat Themelore (FRA). (vi) Mbledh dhe përpunon bazën e të dhënave për veprimtarinë e Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit si dhe të të dhënave në kuadër të raportimeve për procesin e integritetit europian, për të cilat është përgjegjëse kjo strukturë. (vii) Të bashkëpunojë dhe të informojë në mënyrë të vazhdueshme Drejtorin e Shërbimit të Përafrimit dhe të zbatojë detyrat e ngarkuara prej tij. (viii) Të bashkëpunojë me relatorin e komisionit për çështjet europiane për përgatitjen e relatimit për projektligjet që shqyrtohen nga ky komision. (ix) Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme mbledhjet e Komisionit për Çështjet Europiane si dhe në komisionet e tjera parlamentare dhe informon drejtorin e Shërbimit të Përafrimit mbi amendimet që prekin nenet e përafruara të projektligjeve që janë miratuar nga Komisioni për Çështjet Europiane. (x) Të përfshihet dhe angazhohet për përgatitjen e Opinionit të vlerësimit preventiv të Korrupsionit në legjislacion si dhe në kuadër të procesit të Kontrollit Post-Legjislativ. (xi) Të përfshihet dhe të angazhohet në kuadër të Platformës së Konsultimit Publik, duke ndjekur publikimet e akteve në platformë, menaxhuar ndjekjen e komenteve të postuara, përcjelljen e tyre pranë komisionit përkatës dhe dhënien e statusit të komenteve në platformë. (xii) Të përfshihet dhe angazhohet në kuadër të sistemit E-Legis sistemit E-Legis.

103. Ndërsa, në Rregulloren e Kuvendit nr. 42/2015, nenin 21, me titull “Mendimi i Këshilltarit jurist të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit” përcaktohet se, “1. Këshilltari jurist i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit jep mendime, në formë të shkruar për çdo projektligj dhe projektvendim që i paraqiten Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, i cili synon përafrim me instrumentat ligjore të BE, për përafrimin e tyre me acquis të BE-së, shkallën e përputhshmërisë së tyre me pjesët e acquis të BE-së, për përmirësim të përcaktimeve dhe formulimeve të propozuara (duke patur në konsideratë instrumentin ligjor komunitar me të cilin synohet përputhshmëria). 2. Mendimi i drejtohet sipas kërkesës Kryetarit të Kuvendit, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryetarit të Komisionit parlamentar ose çdo deputeti. 3. Në përputhje me programin dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit si dhe të Komisionit përkatës, këshilltari jurist i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit harton mendimin për projektligjin, i cili shpërndahet deputetëve të Komisionit pranë të cilit këshilltari kryen detyrën e tij. Këshilltari jurist i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit jep mendim me shkrim për Kryetarin dhe deputetët e Komisionit edhe nëse projektligji nuk synon përafrim me legjislacionin e BE, duke dhënë vlerësime apo sugjerime për përafrimin e tij në pjesë të caktuara.”

104. Në lidhje me statusin e “Këshilltarit” në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit, aktualisht qasja është e tillë që në mbështetje të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabinetit në disa institucione të Administratës Publike”, ka dalë vendimi nr. 54, datë 26.06.2023 “Për kategorizimin e pozicioneve të punës dhe klasave të nëpunësve të administratës së Kuvendit” i Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë, mbi kategorizimin e pozicioneve të punës për nëpunësit e administratës së Kuvendit, duke kategorizuar pozicionin dhe pagën e “Këshilltarit Juridik/Shërbimi” me kategorinë I, klasa I.5. Sa më sipër, Këshilli çmon se kontributi profesional i kandidatit pranë një organi kushtetues si Kuvendi i Republikës, është në përputhje me standardin e kërkuar nga neni 7/a, i ligjit nr. 8577/2000 “jurist i nivelit të lartë në administratën publike”.

105. Po ashtu përvoja profesionale disa vjeçare e kandidatit si anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 7/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar dhe vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED.

106. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, duke patur në konsideratë përvojën profesionale të kandidatit si gjyqtar, Ndhimëskomisioner dhe Këshilltar pranë Avokatit të Popullit, Ndhimës

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Këshilltar në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvendin e Republikën e Shqipërisë, Anëtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Këshilli çmon se kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

107. Në pikën 5 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në të cilën përcaktohet që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji. Për rrjedhojë kandidati Alma Faskaj (Vokopola) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

108. Gjithashtu, në pikën 5 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse dhe nga formulari i vetëdeklarimit të paraqitur nga kandidati Alma Faskaj (Vokopola), Këshilli konstaton se, kandidati nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji. Për rrjedhojë kandidati Alma Faskaj (Vokopola) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

109. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli vlerëson se kandidati Alma Faskaj (Vokopola) nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Nga të dhënat e konstatuara ndonëse rezulton se, kandidati Alma Faskaj (Vokopola) është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit, nga ana tjetër rezultoi se, vendimi për shkarkim është konsideruar nga Gjykata Kushtetuese në shkelje të procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë kandidati Alma Faskaj (Vokopola) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

110. Për sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/ç të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 229, 235, 236, 237 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe pikave 17, 25, 26, 33, 57, 58, 79, 91 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Alma Faskaj (Vokopola), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Alma Faskaj (Vokopola).
3. Kandidati Alma Faskaj (Vokopola) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ANËTAR
Ilir TOSKA

Zv/KRYETARE
Mariana SEMINI

KRYETAR
Sokol SADUSHI

ANËTARE
Alma MUÇA

ANËTARE ZËVENDËSUESE
Elvana ÇIÇOLLI

ANËTARE
Enkela VLORA

ANËTAR
Etien KAPO

ANËTAR ZËVENDËSUES
Genti XHOLI

ANËTARE
Nafije HASKO

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : ***GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : ***info@ ked.gov.al*** Numra telefonikë : ***+355 4 2257302***